

GUSHT 2024

Nr . (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigja(5)	Statusi i kërkesës (6)	Tarifa (7)
44	1.08.2024	Kërkesë për informacion ne lidhje me: 1.Sa është sipërfaqja e plazheve publike në vend dhe ku janë? 2.Ju lutem, na vini në dispozicion një listë të plazheve publike në vend?	02.08.2024	Agjencia Kombëtare e Bregdetit (në vijim AKB), bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.3.2019 “<i>Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” të ndryshuar:</i> 1. Për sezonin turistik veror 2024, Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA), kryen shqyrtimin e aplikimeve për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 171/2019, të ndryshuar, si dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjektet në funksion të aplikimit. 2. Aplikimet e subjekteve për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, realizohen sipas hartës së plazheve të propozuara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe të miratuara nga Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik Veror, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 171/2019, të ndryshuar, i cili përcakton:	Përfunduar	0

			4. Detyrat e Komitetit të Menaxhimit të Sezonit Turistik janë: a) miratimi i listës së plazheve dhe i hartës së stacioneve të plazheve, sipas tipologjive të tyre, si dhe plazheve publike, bazuar në propozimet e njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat pajisen me një numër të veçantë identifikues, që publikohet në momentin e hapjes së aplikimit online. 3. Referuar hartës së stacioneve të plazhit për sezonin turistik veror 2024, të miratuar nga Komiteti i Menaxhimit të Sezonit turistik, bazuar në propozimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, 70% e sipërfaqes së plazheve janë “të menaxhuara”, pra me ngjyrë të verdhë, 30% e sipërfaqes së plazheve janë “publike”, pra me ngjyrë jeshile. 4. Më poshtë gjeni listen e sipërfaqeve publike sipas njësive vendore. <table><tr><th>Bashkia</th><th>Tipologjia</th><th>Numri I Parcelave</th><th>Shuma e siperfaqes Tipologji</th></tr><tr><td>DIVJAKE</td><td>PUBLIKE</td><td>13</td><td>53,337</td></tr><tr><td>DURRES</td><td>PUBLIKE</td><td>166</td><td>487,919</td></tr><tr><td>FIER</td><td>PUBLIKE</td><td>20</td><td>161,198</td></tr><tr><td>HIMARE</td><td>PUBLIKE</td><td>77</td><td>141,859</td></tr><tr><td>KAVAJE</td><td>PUBLIKE</td><td>46</td><td>100,258</td></tr><tr><td>LEZHE</td><td>PUBLIKE</td><td>53</td><td>215,996</td></tr></table>	Bashkia	Tipologjia	Numri I Parcelave	Shuma e siperfaqes Tipologji	DIVJAKE	PUBLIKE	13	53,337	DURRES	PUBLIKE	166	487,919	FIER	PUBLIKE	20	161,198	HIMARE	PUBLIKE	77	141,859	KAVAJE	PUBLIKE	46	100,258	LEZHE	PUBLIKE	53	215,996		
Bashkia	Tipologjia	Numri I Parcelave	Shuma e siperfaqes Tipologji																														
DIVJAKE	PUBLIKE	13	53,337																														
DURRES	PUBLIKE	166	487,919																														
FIER	PUBLIKE	20	161,198																														
HIMARE	PUBLIKE	77	141,859																														
KAVAJE	PUBLIKE	46	100,258																														
LEZHE	PUBLIKE	53	215,996																														

				POGRADEC	PUBLIKE	18	51,147		
				RROGOZHINE	PUBLIKE	46	131,261		
				SARANDE	PUBLIKE	9	52,903		
				VLORE	PUBLIKE	25	229,601		
				SHKODER	PUBLIKE	50	71,652		
45.	02.08.2024	Kërkesë për informacion ne lidhje me: 1.Sa leje janë dhënë për plazhe private dhe në cilat zona? 2.Sa është qiraja për këto plazhe private dhe cilat janë kriteret e zhvillimit? 3.A është bërë një monitorim i cilësisë së ujërave bregdetare dhe cilat janë rezultatet e këtij monitorimi? 4.A ka shkarkime të ujërave të zeza në bregdet, konkretisht në Sarandë, Himarë, Vlorë, Durrës? Nese po, cilat janë masat e marra? 5.A ka vende të përcaktuara për ankorimin e varkave,	15.08.2024	Në përgjigje të e-mail-it tuaj, përcjelle pranë AKB-se nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për trajtim, mbi veprimtarinë e stacioneve të plazhit, për sezonin turistik veror 2024, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar Ju informojmë si më poshtë vijon: 1. Aktualisht, deri në këto momente AKB ka nënshkruar 884 kontrata qiraje me afat 1 vjeçar për sezonin turistik veror 2024 dhe plus 373 kontrata të tjera, të nënshkruara në vitet e mëparshme, janë në fuqi, me afat 3 dhe 5 vjet, të cilat janë të shpërndara në të gjithë vijën bregdetare. Bashkëlidhur do të gjeni dhe tabelën e shpërndarjes sipas bashkive. 2. Për sa i përket tarifës për metër katror i qirasë sipas zonave apo bashkive, ju bëjmë me dije se: Lista e plazheve dhe harta e stacioneve të plazhit miratohet nga Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik, me propozimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, bazuar në germën “a” të pikës 1 të nenit 4 të VKM-së nr. 171, datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: <i>“Detyrat e Komitetit të Menaxhimit të Sezonit Turistik janë:</i>				Përfunduar	0

	motorëve të ujit dhe anijeve në bregdet? 6. Ku janë këto vende dhe a kryen monitorime? 7.A zbatohen rregullat se ku mund të lundrojnë? Cilat janë kriteret? 8.Ku dhe si shkarkohen ujërat e zeza të anijeve shqiptare dhe të huaja që kalojnë në territorin shqiptar? 9. A ka ndotje të ujërave prej tyre? 10.A ka roje bregdetare në plazhet private dhe publike? 11. Sa roje bregdetare janë në plazhe këtë sezon turistik?	<i>Miratimi i listës së plazheve dhe i hartës së stacioneve të plazheve, sipas tipologjive të tyre, si dhe plazheve publike, bazuar në propozimet e njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat pajisen me një numër të veçante identifikues, që publikohet në momentin e hapjes së aplikimeve online;”</i> Gjithashtu, secila bashki miraton me vendim të Këshillit Bashkiak, për çdo sezon, tarifat e hapësirave për stacion plazhi sipas zonave, si dhe pajis me mandatet e pagesave çdo aplikues, duke qenë se njësitë vendore janë institucionet përfituese të ardhurave nga kontraktimi i sipërfaqes së plazheve. 3. Për sa i përket pyetjes tuaj 3 dhe 4 lidhur me monitorimin e cilësisë së ujërave bregdetare, rezultatet dhe vend shkarkimet e ujërave të zeza, ju sqarojmë se, referuar VKM-së nr. 569, datë 17.07.2019, “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit” i ndryshuar, monitorimi i cilësisë së ujërave bregdetare dhe shkarkimi i ujërave të zeza nuk hyn në kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit. 4. Ne lidhje me pyetjen 5, mbi vendet e përcaktuara për ankorim ju bëjmë më dije se: Korridor hyrje dalje të mjeteve lundruese, miratohen nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores "<i>Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit</i>", të ndryshuar, neni 4, që përcakton: <i>1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe ministrinë përgjegjëse për turizmin, përgatisin hartën e përgjithshme për plazhet e lejuara, e cila përmban, ndër të tjera dhe</i>	
--	--	--	--

				e) vendbazimet e mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre; Ndërsa, aplikimet për stacione sezonale të ankorimit/bregëzimit, bazuar në parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 29.4.2022 "<i>Për kriteret e vendosjes dhe të funksionimit të stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit</i>", shqyrtohen nga Komisioni përkatës, pranë AKB-së. AKB aktualisht ka nënshkruar kontratë për vetëm 2 stacione ankorim bregëzimi, një në zonën e Vlorës dhe një në Lezhë. Për sa i përket rregullave dhe kriterëve se ku këto mjete lundruese duhet të lundrojnë, janë të përcaktuara në Ligjin nr.43/2020 "Për aktivitetet e turizmit detar". Monitorimi i mjeteve lundruese kryhet nga Policia Kufitare, sipas zonave të lundrimit për qëllime turistike dhe argëtimi , të cilat miratohen nga KKT sipas Vendimit nr. 2, datë 28.07.2020 "Për përcaktimin e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit detar dhe miratimin e hartës së aktiviteteve" 5. Në lidhje me pyetjen 8 dhe 9 mbi shkarkimin e ujërave të zeza të anijeve dhe ndotjes që ato shkaktojnë, ju sqarojmë gjithsesi se nuk është pjesë e kompetencave të AKB-së dhe nuk monitorohet nga ana jone. 6. Për sa i përket rojeve bregdetare në plazhet private dhe publike, ju sqarojmë se: Duke filluar nga sezoni turistik veror 2020, prania e vrojtuesit të plazhit është kusht për nënshkrimin e kontratës për përdorimin e hapësirës së plazhit nga subjektet., ndaj sipas parashikimeve të VKM-së 171/2020, AKB, ka proceduar me nënshkrimin e kontratës për		
--	--	--	--	---	--	--

				përdorimin e hapësirës së plazhit, me subjektet vetëm pas paraqitjes nga ana e tyre, të marrëveshjes së noterizuar me vrojtuesin e plazhit (shoqëruar me certifikatën përkatëse të kualifikimit). Nga qendrat e formimit profesional, nga informacioni që disponohet nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit rezultojnë rreth 1400 vrojtues të certifikuar. Me qëllim sigurimin e standardeve në fushën e turizmit, nga AKB dhe Agjencitë Rajonale të Bregdetit, në fillim të sezonit turistik veror 2024 dhe në vijim, janë informuar të gjithë subjektet që operojnë në zonën bregdetare, lidhur me rëndësinë e plotësimit të kriterëve dhe standardeve në plazhe, ku mbi të gjitha është theksuar rëndësia e pranisë së vrojtuesit të plazhit, gjatë gjithë kohës që stacioni i plazhit qëndron i hapur, niveli i pastërtisë në terren, sinjalistika, si dhe tabelat informuese të vendosura në vende të dukshme.		
46	15.08.2024	Kërkesë për informacion ne lidhje me:-A është lëshuar autorizim nga ministri i mjedisit për eksportim te mbetjeve te rrezikshme, për mbetjet qe do shkonin ne Tajlandë rreth datës 20 gusht? -A ka paraqitur kompania eksportuese pranë ministrisë tuaj destinacionin e mbetjeve ?	17.08.2024	Në përgjigje të interesimit tuaj në lidhje me dyshimet mbi transportin e parregullt të një sasive mallrash me përmbajtje mbetjesh të dala nga procesi teknologjik, sqarojmë se për këtë rast Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka dhënë asnjë autorizim dhe si rrjedhojë kompania nuk ka paraqitur të dhëna mbi destinacionin e ngarkesës. Sa më sipër, ju informojmë se institucionet ligjzbatuese shqiptare janë angazhuar që në sinjalizimin e parë të këtyre dyshimeve dhe kanë kryer veprime hetimore të përbashkëta me Zyrën kundër mashtrimit të Bashkimit Evropian (OLAF) si dhe kanë referuar rastin pranë organeve të prokurorisë.	Përfunduar	0

		- Nga statistikat tuaja, këto mbetje te rrezikshme nga e kane origjinën? -Çfarë masash po ndërmer ministria e mjedisit për te parandaluar eksportin/importin e paligjshëm te mbetjeve te rrezikshme?		Vëllimet e mallrave të cilat dyshohen se përmbajnë mbetje të dala nga procesi teknologjik i realizuar nga kompani ndërkombëtare që operojnë pranë kompleksit metalurgjik në Elbasan, janë ngarkuar në njësi kontejnerike pranë Terminalit të Mallrave Rifuxhio në Durrës, i cili operohet nga kompania koncesionare gjermane EMS. Në vijim, këto njësi kontejnerike, në pronësi të linjës ndërkombëtare MSC, dyshohet se janë transportuar drejt Portit të Triestes përmes anijeve kontejnerike ndërkombëtare. Në këtë port të Bashkimit Evropian njësitë kontejnerike nuk kanë qënë objekte kontrollesh dhe janë lejuar të vijojnë itinerarin e tyre duke u transportuar në anije të operuar nga një tjetër operator i mirënjohur ndërkombëtar (Maersk), me destinacion Azinë Juglindore. Vlen të theksojmë se konventat ndërkombëtare, dhe legjislacioni vendas i përputhur me to, parashikojnë një serë detyrimesh për prodhuesit dhe transportuesit e mbetjeve të tilla. Zbatimi i këtyre detyrimeve është gjithashtu objekt i hetimeve në proces. Autoritetet mjedisore, portuale dhe doganore shqiptare operojnë prej vitesh me protokolle shumë të rrepta për sa i përket autorizimeve të përpunimit dhe transportit të mallrave të rrezikshme, në përputhje me konventat ndërkombëtare përkatëse. Për më tepër kjo gatishmëri e institucioneve tona kombëtare është verifikuar dhe certifikuar edhe nga inspektime të vijueshme ndërkombëtare përgjatë viteve të fundit, duke e renditur Shqipërinë si një vend të sigurt.		
--	--	--	--	--	--	--

				Institucionet shqiptare mbeten në kontakt dhe bashkëveprim me partnerët evropianë për kryerjen e hetimeve të plota dhe transparente të të gjitha rrethanave dhe të të gjithë hallkave logjistike që kanë kryer këtë transport të dyshuar nga Europa në Azinë Juglindore.		
47	15.08.2024	Kërkesë për informacion ne lidhje me:-1. a) Kopje të autorizimit të firmosur nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit për subjektin që ka patur si qellim eksportin e mbetjeve për Tajlandë nëpërmjet anijeve “*****” dhe “*****”. b) Cili është eksperti i mjedisit i licensuar për të specifikuar origjinën e mbetjeve në kërkesën e subjektit? 2. Në rast se mbetjet për eksport do të rikthehen në Shqipëri, si do të trajtohen ligjërisht këto mbetje?(Import/ Trajtim si dhe ku depozitohen??) 3. A është njoftuar zyrtarisht Drejtoria e Përgjithshme e Doganës nga MTM për	29.08.2024	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka dhënë asnjë autorizim dhe si rrjedhojë kompania nuk ka paraqitur të dhëna mbi destinacionin e ngarkesës. Konventat ndërkombëtare, dhe legjislacioni vendas i përputhur me to, parashikojnë një serë detyrimesh për prodhuesit dhe transportuesit e mbetjeve të tilla. Në rast paligjshmërie krijuesi i mbetjeve do të përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga legjislacionet në fuqi. Institucionet ligj zbatuese shqiptare janë angazhuar që në sinjalizimin e parë të këtyre dyshimeve, si dhe MTM ka referuar rastin pranë autoriteteve doganore me qëllim investigimin dhe vlerësimin e situatës. Institucionet shqiptare mbeten në kontakt dhe bashkëveprim me partnerët evropianë për kryerjen e hetimeve të plota dhe transparente të të gjitha rrethanave dhe të të gjithë hallkave logjistike që kanë kryer këtë transport të dyshuar nga Europa në Azinë Juglindore.	Përfunduar	0

		eksportin e mbetjeve ose anasjelltas, si detyrim i pikës 36 të VKM – së Nr. 641, , datë 1.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve”?				
48	19.08.2024	Kërkesë për informacion në lidhje me:1. A ka qenë në dijeni Ministria e Mjedisit dhe Turizmit për eksportin e mbetjeve të rrezikshme nga Shqipëria në Tajlandë? Nëse jo, si u largua kjo dërgesë nga Shqipëria pa autorizimin e duhur? 2. Çfarë hapash po ndërmerr Ministria për të hetuar dhe verifikuar përmbajtjen e mbetjeve të eksportuara? 3. A ka pasur ndonjë bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, siç është Basel Action Network (BAN), për të adresuar eksportin e paligjshëm të mbetjeve të rrezikshme nga Shqipëria? 4. Çfarë veprimesh do të ndërmerren nëse konfirmohet se mbetjet e	22.08.2024	Në përgjigje të interesimit tuaj në lidhje me dyshimet mbi transportin e parregullt të një sasive mallrash me përmbajtje mbetjesh të dala nga procesi teknologjik, sqarojmë se për këtë rast Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka dhënë asnjë autorizim dhe si rrjedhojë kompania nuk ka paraqitur të dhëna mbi destinacionin e ngarkesës. Sa më sipër, ju informojmë se institucionet ligj zbatuese shqiptare janë angazhuar që në sinjalizimin e parë të këtyre dyshimeve dhe kanë kryer veprime hetimore të përbashkëta me Zyrën kundër mashtrimit të Bashkimit Evropian (OLAF). Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është në kontakt dhe komunikim të vazhdueshëm me drejtorin ekzekutiv të organizatës ndërkombëtare Basel Action Network, si dhe autoritet doganore të Republikës së Shqipërisë në lidhje me eksportin e mbetjeve të dyshuara. Institucionet shqiptare mbeten në kontakt dhe bashkëveprim me partnerët evropianë për kryerjen e hetimeve të plota dhe transparente të të gjitha rrethanave dhe të të gjithë hallkave logjistike që kanë kryer këtë transport të dyshuar nga Europa në Azinë Juglindore. Vlen të theksojmë se konventat ndërkombëtare, dhe legjislacioni vendas i përputhur me to, parashikojnë një seri detyrimesh për prodhuesit dhe transportuesit e mbetjeve të tilla. Në rast paligjshmërie krijuesi i mbetjeve	Përfunduar	0

		rrezikshme janë eksportuar në mënyrë të paligjshme? 5. Çfarë masash po zbatohen për të parandaluar eksportet e ardhshme të paligjshme të mbetjeve të rrezikshme nga Shqipëria?		do të përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga legjislacionet në fuqi. Organet ligjzbatuese, autoritet doganore dhe strukturat inspektuese janë në komunikime të vazhdueshëm për rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit, me qëllim përmirësimin dhe sigurimin e një mbarëvajtje sa më të mirë të procesit të eksportit dhe tranzitimit të mbetjeve.		
49	21.08.2024	Kërkesë për informacion ne lidhje me: 1. Cila është lista e mbetjeve të rrezikshme që aktualisht nuk lejohen të importohen në Shqipëri? 2. Cilat janë mbetjet e rrezikshme që prodhon vetë Shqipëria? 3. Ku depozitohen aktualisht mbetjet e rrezikshme që prodhon vetë Shqipëria? 4. Si bëhet përpunimi i mbetjeve të rrezikshme dhe cilat janë kompanitë që bëjnë përpunimin e tyre? 5. Referuar projektligjit "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" (të hedhur për konsultim publik), cila	04.09.2024	. Cila është lista e mbetjeve të rrezikshme që aktualisht nuk lejohen të importohen në Shqipëri? Në bazë zbatim të nenit 48 "Ndalimi i importeve dhe kalimi transit i mbetjeve", kreu IX "Importi dhe Eksporti i Mbetjeve" të ligjit 10 463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, në Republikën e Shqipërisë ndalohej në të gjitha rastet importimi i mbetjeve të rrezikshme. 2. Cilat janë mbetjet e rrezikshme që prodhon vetë Shqipëria? Bazuar në VKM-në nr. 402 datë 30.06.2021 "Për miratimin e katalogut të mbetjeve", janë të listuara të gjitha kodet e mbetjeve të rrezikshme dhe të parrezikshme, sipas origjinës dhe përbërjes së tyre. Sipas katalogut të mbetjeve janë 413 tipe mbetjesh të rrezikshme. 3. Ku depozitohen aktualisht mbetjet e rrezikshme dhe cilat janë kompanitë që bëjnë përpunimin e tyre? Mbetjet e rrezikshme sipas Ligjit 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve trajtohen nëpërmjet procesit të rikuperimit, riciklimit dhe asgjësimit sipas metodave të ligjore të përcaktuara. <i>"Rikuperim" është çdo operacion, rezultati kryesor i të cilit është që: a) mbetjet të shërbejnë për një qëllim të dobishëm,</i>	Përfunduar	0

		është lista e mbetjeve që do të lejohen për import?		duke zëvendësuar materiale të tjera, që do të përdreshin në rast të kundërt për të përmbushur një funksion të caktuar; b) mbetjet të përgatiten për të përmbushur një funksion të caktuar në një implant apo më gjerë. “Riciklim” është çdo operacion rikuperimi, me anë të të cilit materialet e mbetjeve ripërpunohen për t’u shndërruar në produkte, materiale apo substanca, për t’u përdorur, si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera. Riciklimi përfshin ripërpunimin e materialeve organike, por nuk përfshin rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin që u bëhet mbetjeve për t’i shndërruar në materiale që përdoren si lëndë djegëse apo si lëndë mbushëse “Asgjësimit” është çdo operacion që nuk është rikuperim edhe kur operacioni ka si pasojë dytësore rikuperimin e substancave ose të energjisë. Mbetjet nuk duhet të ruhen në vendndodhje për një periudhë më të gjatë se 1 vit në qoftë se ato janë të përcaktuar për asgjësim ose jo më shumë se 3 vjet nëse ato janë të paracaktuar për riciklim/trajtim. Lista e kompanive të cilat bëjnë përpunimin e mbetjeve është e afishuar pranë QKB-se. 4. Si bëhet përpunimi i mbetjeve të rrezikshme dhe cilat janë kompanitë që bëjnë përpunimin e tyre. Është dhënë në përgjigjen më sipër. 5. Referuar projektligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve“ (të hedhur për konsultim publik), cila është lista e mbetjeve që do të lejohen për import? Ligji vazhdon të jetë në procesin e konsultimit publik.		
50	21.08.2024	Kërkesë për informacion në lidhje me: 1. A kishte dijeni Ministria e Mjedisit në lidhje me dërgesat me	29.08.2024	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka dhënë asnjë autorizim dhe si rrjedhojë kompania nuk ka paraqitur të dhëna mbi destinacionin e ngarkesës.	Përfunduar	0

		mbetje të rrezikshme drejt Tajlandës dhe Kinës? 2. Cilat janë kompanitë që kanë transportuar kontejnerët me këto mbetje të rrezikshme? 3. A keni informacion se çfarë lloj mbetjesh janë transportuar në këto kontejnerë? 4. Çfarë masash janë marrë nga Ministria e Mjedisit pas evidentimit të këtyre rasteve? 5. A keni informacion në lidhje me dërgesa të tjera të kryera?		Ju informojmë se institucionet ligj zbatuese shqiptare janë angazhuar që në sinjalizimin e parë të këtyre dyshimeve dhe kanë kryer veprime hetimore të përbashkëta me Zyrën kundër mashtrimit të Bashkimit Evropian (OLAF), si dhe MTM ka referuar rastin pranë autoriteteve doganore me qëllim investigimin dhe vlerësimin e situatës. Vlen të theksojmë se konventat ndërkombëtare, dhe legjislacioni vendas i përputhur me to, parashikojnë një serë detyrimesh për prodhuesit dhe transportuesit e mbetjeve të tilla. Në rast paligjshmërie krijuesi i mbetjeve do të përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga legjislacionet në fuqi. Institucionet shqiptare mbeten në kontakt dhe bashkëveprim me partnerët evropianë për kryerjen e hetimeve të plota dhe transparente të të gjitha rrethanave dhe të të gjithë hallkave logjistike që kanë kryer këtë transport të dyshuar nga Evropa në Azinë Juglindore.		
51	22.8.2024	Kërkesë për informacion ne lidhje me: 1.Sa leje eksporti të mbetjeve janë dhënë nga Ministria e Mjedisit përgjatë viteve 2023 dhe 2024? 2.Për cilat destinacione janë dhënë këto leje?	04.09.2024	Gjatë vitit 2023 nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit janë lëshuar në total 56 Autorizime për eksportin e mbetjeve të rrezikshme, jo të rrezikshme jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe kalim tranzit nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vitin 2024 deri më tani nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit janë lëshuar në total 28 Autorizime për eksportin e mbetjeve të rrezikshme, jo të rrezikshme jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe kalim tranzit nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë.	Përfunduar	0

		3. Sa është sasia e mbetjeve të eksportuara në vitet 2023 dhe 2024? 4. Sa dhe cilat janë industritë që prodhojnë mbetje të papërpunueshme në Shqipëri? Ku depozitohen këto mbetje? 5. Cilat janë dispozitat ligjore në lidhje me prodhimin, përpunimin dhe depozitim të këtyre mbetjeve?	Destinacionet më të shpeshta për eksportin e mbetjeve janë kryesisht vendet e Europës disa nga të cilat janë si më poshtë: Greqia, Maqedonia e Veriut, Italia, Sllovenia, Polonia, Gjermania, Turqia, Bullgaria, Holanda, Belgjika etj. Në zbatim të Ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit çdo vit publikon në faqen zyrtare të saj, raportin e Gjendjes në Mjedis, ku një kapitull i veçantë është për Menaxhimin e Mbetjeve dhe jepen të dhëna për situatën e sektorit të mbetjeve në Republikën e Shqipërisë, Përpunimi i të dhënave lidhur me sasinë e eksportit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme bëhen në fund të vitit dhe publikimi i tyre bëhet në fillim të vitit pasardhës. Personi që eksporton mbetje ruan të dhënat për çdo ngarkesë dhe dërgon informacion zyrtar për sasinë e mbetjeve që do të eksportohen, çdo 6 muaj në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, nga data e lëshimit të këtij autorizimi. Klasifikimi i mbetjeve bëhet sipas Ligjit 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, si dhe emërtimi sipas VKM-së Nr.402 datë 30.06.2021 “Për Miratimin e katalogut të mbetjeve” ku jepet lista e mbetjeve, sipas origjinës dhe përbërjes së tyre. Në Katalogun e mbetjeve, nga 953 specifikime kodi mbetje në total, 418 prej tyre klasifikohen si mbetje të rrezikshme. Mbetjet nuk duhet të ruhen në vendndodhje për një periudhë më të gjatë se 1 vit në qoftë se ato janë të përcaktuar për asgjësim ose jo më shumë se 3 vjet nëse ato janë të paracaktuar për riciklim/trajtim. Për kodet e mbetjeve të cilat nuk mund të trajtohen, riciklohen, ripërdoren apo asgjësohen në vendin tone është e rregulluar dispozita ligjore për të eksportuar në vendet të cilat i mundësojnë këto procese.		
--	--	---	---	--	--

52	23.08.2024	Kërkesë për informacion ne lidhje me 1. Praktikën ligjore dhe dokumentacionin e plotë të lidhur me dy anijet (***** me 40 kontenierë dhe ***** me 60 kontenierë), ngarkuar me mbetje të rrezikshme drejt Tajlandës, të bllokuara dhe me destinacion kthimi Shqipëri në format origjinal të njehësuar. Gjithashtu kërkojmë informacionet si më poshtë: 1. Nisur nga ky incident, a ka pasur raste të tjera kur qeveria shqiptare është bërë me dije për aktivitetet e paligjshme në lidhje me transportin e mbetjeve të rrezikshme? Nëse po, jeni të lutur të ndani detajet. 2. Çfarë praktikash të ngjashme ekzistojnë dhe si janë menaxhuar deri më tani? 3. Ka patur në të kaluarën, ka aktualisht ose në pritje licenca shtetërore për biznese shqiptare apo të huaja për depozitimin e mbetjeve apo për transportin		Në proces		

		e mbetjeve nga jashtë vendit për në Shqipëri?				
53	23.08.2024	Kërkesë për informacion ne lidhje me: 1- Sa tonë mbetje të rrezikshme prodhon Shqipëria në vit? 2- Si trajtohen ose menaxhohen mbetjet e rrezikshme në Shqipëri? 3- A ka sot Shqipëria impiant të trajtimit të mbetjeve të rrezikshme? Nëse po ku ndodhet dhe me çfarë tarifash është për bizneset? 4- Sa tonë mbetje të rrezikshme janë trajtuar brenda vendit dhe sa janë eksportuar jashtë vendit nga 1 janari 2023-gusht 2024? 5- Në rast se anijet ***** rezultojnë me mbetje toksike, ku do të shkojnë ato pasi të kthehen në Shqipëri? Çfarë do të ndodhë me ngarkesën e tyre?	03.09.2024	Menaxhimi i mbetjeve bëhet sipas përcaktimeve ligjore në ligjin Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe në lejet mjedisore përcaktohet mënyra e trajtimit të tyre. Bazuar ne Ligjin 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, te ndryshuar, si VKM-së Nr.402 datë 30.06.2021 “ Për Miratimin e katalogut të mbetjeve”, Klasifikimi dhe emërtimi i kodeve të mbetjeve bëhet, sipas origjinës dhe përbërjes se tyre. Në Katalogun e mbetjeve, nga 953 specifikime kodi mbetje ne total, 418 prej tyre klasifikohen si mbetje të rrezikshme. Në mbështetje të shtojcës 3 "Vetitë e mbetjeve që i klasifikojnë ato si te rrezikshme", te ligjit te sipërcituar, mbetjet e rrezikshme klasifikohen ne nënndarje te tjera si shpërthyes, oksiduese, irrituese, dëmtuese, te djegshme e me radhe. Mbetjet e rrezikshme sipas Ligjit 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, te ndryshuar, trajtohen nëpërmjet procesit të rikuperimit, riciklimit dhe asgjësimit sipas metodave ligjore të përcaktuara. Mbetjet nuk duhet të ruhen në vendndodhje për një periudhë më të gjatë se 1 vit në qoftë se ato janë të përcaktuar për asgjësim ose jo më shumë se 3 vjet nëse ato janë të paracaktuar për riciklim/trajtim. Vendi ynë nuk ka impiant incenerimi për mbetje te rrezikshme. Për sa i përket projekt ligjit "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" vazhdon te jetë ne procesin e konsultimit publik.	Përfunduar	0

54.	04.09.2024	Kërkesë për informacion ne lidhje me: Sa turistë të huaj kanë vizituar Shqipërinë ne 7 muajt e parë të vitit 2024? Sa dhoma hoteli ishin të regjistruara dhe në përdorim nga turistët nga Janari deri në Korrik 2024? Sa dhoma hoteli ishin të regjistruara dhe në përdorim nga turistët për vitin 2023?		Në proces		

Shënim:

Regjistri përditësohet çdo muaj.

- (1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.
- (2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.
- (3) Identifikohet lloji i kërkesës.
- (4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.

(Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”)

(5) Ndihmon kërkuesin për të njohur ecurinë e procesit.

(6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.